



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere
Mbledhja nr.16/24
Prishtinë, më 25.9.2024, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, Salla C-203

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Armend Muja, Enver Haliti, Jeta Statovci, Visar Korenica, Eman Rrahmani, Avdullah Hoti, Pal Lekaj, Duda Balje.

Munguan: Ferat Shala, Mërgim Lushtaku.

Të ftuar: Ahmet Ismaili, guvernator, BQK, Bashkim Nurboja, anëtar bordi, BQK.

Pjesëmarrësit tjerë: Festim Bytyçi, këshilltar, GP- AAK; Sami Gashi, GP- LVV, Elsa Krasniqi, GP-LVV, Nexhmije Ahmeti, zyrtare e mediave, Kuvendi i Kosovës.

Stafi mbështetës i Komisionit: Sabrije Saliuki-Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli, Frina Kabashi, praktikante D+.

Rendi i ditës

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 28.6.2024 dhe 10.7.2024;**
- 3. Votimi i raportit vjetor financiar i Buxhetin të Republikës së Kosovës për vitin 2023;**
- 4. Votimi i raportit vjetor financiar i Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2023;**
- 5. Votimi i raportit vjetor financiar i Këshillit Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2023;**
- 6. Votimi i raportit vjetor financiar i Agjencisë për Informim dhe Privatësi për vitin 2023;**
- 7. Votimi i raportit vjetor financiar i Autoritetit Rregullator të Shërbimit të Ujit për vitin 2023;**
- 8. Votimi i raportit vjetor financiar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil për vitin 2023;**
- 9. Shqyrtimi i propozimeve të Komisionit për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale;**
- 10. Shqyrtimi i raportit vjetor i punës së Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2023;**
- 11. Formimi i grupit punues për Projektligjin nr. nr.08/L-304 për bankat;**
- 12. Miratimi i raportit të punës së Komisionit për sesionin pranveror për vitin 2024;**
- 13. Shqyrtimi i draft-planit të punës së komisionit për sesionin vjeshtor për vitin 2024;**
- 14. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se me shumicë votash u miratua rendi i ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 28.6.2024 dhe 10.07.2024

Kryetari pyeti anëtarët e Komisionit, se a kanë ndonjë vërejtje në procesverbalet e datës 28.6.2024, dhe 10.07.2024, pasi nuk kishte vërejtje, e vendosi në votim, ku me shumicë votash, u miratuan procesverbalet e datave 28.6.2024 dhe 10.7.2024.

3. Votimi i raportit vjetor financiar i Buxhetin të Republikës së Kosovës për vitin 2023

Kryetari: Ju njoftoj se për këtë pikë kemi diskutuar në mbledhjet e mbajtura të Komisionit, më datë 10 dhe 17 korrik 2024, andaj sot e procedojmë për votim.

Kryetari konstatoi se me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet raporti vjetor financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2023.

4. Votimi i raportit vjetor financiar i Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2023

Kryetari: Ju njoftoj se për këtë pikë kemi diskutuar në mbledhjen e mbajtur të Komisionit, më datë 24 prill 2024, andaj sot e procedojmë për votim.

Kryetari konstatoi se me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

Raport

Miratohet raporti vjetor financiar i Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2023.

5. Votimi i raportit vjetor financiar i Këshillit Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2023

Kryetari: Ju njoftoj se për këtë pikë kemi diskutuar në mbledhjen e mbajtur të Komisionit, më datë 8 maj 2024, andaj sot e procedojmë për votim.

Kryetari konstatoi se me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

Raport

Miratohet raporti vjetor financiar i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, për vitin 2023.

6. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Agjencisë për Informim dhe Privatësi për vitin 2023

Kryetari: Ju njoftoj se edhe për këtë pikë, diskutimet kanë përfunduar në mbledhjen e mbajtur, më datë 24 prill 2024, andaj sot e procedojmë për votim.

Kryetari konstatoi se me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

Raport

Miratohet raporti vjetor financiar i Agjencisë për Informim dhe Privatësi për vitin 2023.

7. Votimi i raportit vjetor financiar i Autoritetit Rregullator të Shërbimit të Ujit për vitin 2023

Kryetari: Ju njoftoj se edhe për këtë pikë, diskutimet kanë përfunduar në mbledhjen e mbajtur, më datë 22 maj 2024, andaj sot e procedojmë për votim.

Kryetari konstatoi se me 3 vota për dhe 3 abstenime, nuk miratohet raporti i ARRSHU-së për vitin 2023.

8. Votimi i raportit vjetor financiar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil për vitin 2023

Kryetari: Ju njoftoj se edhe për këtë pikë, diskutimet kanë përfunduar në mbledhjen e mbajtur më datë 22 maj 2024, andaj sot e procedojmë për votim.

Kryetari konstatoi se me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

Raport

Miratohet raporti vjetor financiar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2023.

9. Shqyrtimi i propozimeve të Komisionit për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale

Kryetari: Më datë 20.9.2023, Komisioni për Përzgjedhjen e Anëtarëve të Bordit drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK), ka dërguar propozimin për emërimin e anëtarëve të Bordit drejtues të FKPK.

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere është ngarkuar që ta shqyrtojë lëndën dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

Në bazë të nenit 29 dhe 110 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, shqyrton propozimin e Komisionit për Përzgjedhje, për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Në bazë të nenit 4 të Ligjit nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me nenin 2 paragrafi 1. të Ligjit nr. 05/L-116, Komisioni për Përzgjedhje të anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, në përbërje nga: Ahmet Ismaili, guvernator i BQK-së (kryesues i komisionit), Hekuran Murati, ministër i Financave (anëtar i komisionit) dhe Vlora Spanca, auditore e Përgjithshme (anëtare e komisionit), ka hapur konkursin, ka bërë intervistimin e kandidatëve, aplikacionet e të cilëve janë konsideruar si më relevante nga komisioni dhe që kanë plotësuar kriteret formale.

Komisioni për Përzgjedhje, në pajtim me nenin 4, paragrafi 10 të Ligjit nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, ka bërë verifikimin e përshtatshmërisë së kandidatëve, i cili ka rezultuar se asnjëri nga kandidatët e propozuar nuk ka pengesë sipas këtij kriteri.

Si rrjedhojë, në pajtim me nenin 4, paragrafi 6 dhe paragrafi 11 të Ligjit nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, Komisioni për Përzgjedhje, i ka propozuar Kuvendit, që të emërojë dy (2) kandidatë për anëtarë të Bordit Drejtues të Fondit Pensional, si në vijim:

- | | | |
|-------------------------|----------|------------------------------|
| 1. Arsim Bruçaj, | (anëtar) | (24,7 nga 30 pikë maksimale) |
| 2. Ali Vitija, | (anëtar) | (22,3 nga 30 pikë maksimale) |

Mandati i anëtarëve të emëruar në Bordin Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale, është katërvjeçar, në pajtim me nenin 4, paragrafin 6 të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me nenin 2, paragrafin 1 të Ligjit nr. 05/L-116.

Eman Rrahmani, kërkoi që të njëjtit të prezantohen para komisionit.

Pal Lekaj, kundërshtoi me arsyen se të njëjtit nuk i plotësojnë kushtet konform nenit 4, pika 5 dhe theksoi se raporti vjetor i trustit po shpërfillet.

Abdullah Hoti, në raportin vjetor të trustit mungojnë dy përfaqësuesit kryesorë dhe kjo mungesë ndikon në vendimmarrje.

Pas diskutimeve, Komisioni, njëzëri, u pajtuan që të mbahet një mbledhje, ku prezentë të jenë Komisioni Përzgjedhës, ne perberje: z. Hekuran Murati, ministër i Financave, Punës dhe Transfereve, guvernatori i BQK-së, z. Ahmet Ismaili dhe auditorja e Përgjithshme, znj. Vlora Spanca.

10. Formimi i grupit punues për Projektligjin nr.08/L-304 për bankat

Kryetari: Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65(1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 74 të Rregullores së Kuvendit, në seancën plenare të mbajtur më 11 korrik 2024, pas shqyrtimit në parim të Projektligjit nr.08/L-304 për bankat, ka ngarkuar Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere, si Komision funksional, që ta shqyrtojë Projektligjin për bankat dhe Kuvendit t'i paraqesë raportin me amendamente.

Pra, propozoj që të nxjerrim vendim për formimin e grupit punues për **Projektligjin nr.08/L-304 për bankat**, nëse jeni edhe ju të pajtimit.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan që grupi punues për Projektligjin nr.08/L-304 për bankat, të jetë në përbërje të të gjithë anëtarëve të Komisionit.

11.Miratimi i raportit të punës së Komisionit për sesionin pranveror për vitin 2024

Kryetari: Në materialet e dërguara, e keni edhe raportin e **punës së Komisionit për sesionin pranveror për vitin 2024**, në të cilin ofrohen të dhëna të detajuara rreth aktiviteteve të Komisionit gjatë sesionit pranveror. Nëse keni diçka për të shtuar, atëherë e hapim diskutimin.

Kryetari konstatoi që me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Miratohet raporti i punës së Komisionit për sesionin vjeshtor të vitit 2024.

12. Shqyrtimi i draft-planit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor për vitin 2024

Kryetari: Në bazë të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, harton planin dhe programin e punës për sesionin vjeshtor për vitin 2024. Plani përfshin objektivat, rregullat për funksionimin e brendshëm të komisionit, fushëveprimin, aktivitetet dhe detyrat e komisionit, si dhe synimet për arritjen e objektivave të përcaktuara me planin e punës. Aktivitetet kryesore të komisionit, gjatë sesionit vjeshtor për vitin 2024, do të jenë: shqyrtimi/hartimi dhe amendamenti i projektligjeve dhe dokumenteve tjera të ndërlidhura; shqyrtimi i raporteve vjetore të punës dhe financiare të shpenzimeve të institucioneve raportuese; organizimi i dëgjimeve publike dhe seancave dëgjimore; mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve përkatëse dhe çështje të tjera. Plani i punës së komisionit mund të ndryshohet dhe të plotësohet, sipas nevojës dhe aktiviteteve të komisionit.

Kryetari konstatoi se me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Miratohet plani i punës së Komisionit për sesionin vjeshtor të vitit 2024.

13. Shqyrtimi i raportit vjetor i punës të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2023

Kryetari: Në bazë të nenit 28 dhe nenit 59 të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, brenda gjashtë muajve, pas mbylljes së vitit financiar, Banka Qendrore duhet t'i dorëzojë Kuvendit një raport të miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore, në lidhje me operacionet dhe punët e BQK-së, gjatë vitit financiar që ka përfunduar, objektivat e politikave të saj, gjendjen e sistemit financiar dhe ngjarjet që kanë ndikuar në ekonominë e Kosovës, si dhe një parashikim mbi ekonominë e vitit në vijim.

BQK ka dorëzuar në Kuvend raportin vjetor të punës për vitin 2023, për të cilin Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në cilësinë e Komisionit funksional, është ngarkuar që të shqyrtojë raportin dhe ta paraqesë raportin me rekomandime për Kuvendin.

Lidhur me këtë pikë, kemi ftuar anëtarët e Bordit dhe guvernatori e BQK-së, z. Ahmet Ismailin, nga i cili kërkojmë që ta prezantojë dhe ta arsyetojë raportin në fjalë.

Ahmet Ismajli, guvernator i BQK-së, paraqiti raportin për vitin 2023, i cili raport, brenda rregullave, është i qëndrueshëm me pasqyrat financiare, por që lë vend për përmirësim.

Sipas tij, rritja e kostos së financimit të ekonomisë në Eurozonë ka pasur rritje 0.4% në vitin 2023 dhe është zvogëluar në 5.4%, ndërsa në vitin 2024 ka pasur inflacion në 2.5%.

Në Ballkanin Perëndimor rritja ka qenë 3%, norma mesatare e inflacionit është rritur në 7.7%, nga 11.6%.

Ekonomia e Kosovës, pa i cekur ndryshimet e fundit të ASK-së, ka pasur rritje prej 3.3%.

BQK pret rritje në 2.5%, deri në fund të vitit 2024.

Vlera e remitancave të pranuar në vitin 2023 ka arritur në 1.3 miliard euro, që do të thotë 9.9% më shumë se në vitin paraprak, ndërsa investimet e huaja kanë arritur vlerën prej 844 milionë euro apo 15.3% rritje.

Sa i përket sektorit financiar 11.1 miliardë euro, që është një rritje e shpejtuar e asetëve me 12.4%, ndërsa përfshirja e 136 institucioneve të licencuara nga BQK, 583 ATM, 17200 POS, 1930 zyra të licencuara, me 6704 të punësuar, 1.6 milion kredit kartela në treg, me një sektor bankar prej 11.5% rritje me ekonomi familjare 17.3% dhe rritje në sektorë të tjerë. Sektori financiar ka pasur një performancë të lartë me fitime prej 155.3 milionë euro, me një rritje 10.7%, për dallim nga viti paraprak, që rritja ka qenë 20% në vlerë kredie. Në vazhden e raportimit të tij, ankesat, dëmet e paguara, sigurimet, depozitat, menaxhimi i parasë së gatshme, bashkëpunimi me Bankën Botërore për anëtarësim në SEPA, pasqyrat financiare të auditorit, ulja e kamatave të bankave, përmbledhi raportimin për vitin 2023.

Eman Rrahmani, tha se raporti nuk është i mirëqenë si shpjegim, nuk ka hulumtime të sakta për shifra të kategorizuara dhe mungon një informacion i detajuar nga BQK. Lidhur me rregulloret,

pyeti: pse BQK ende nuk e ka nxjerrë një rregullore për kredi të kamatave, a ka ndonjë planifikim BQK, lidhur me afatet kohore për rregulloren në fjalë, e cila është me interes?

Ahmet Ismajli, u përgjigj se nuk ka pengesa për bankingun tradicional, por është projekti i Bankës Botërore FINSAC, me dinamike properëndimore.

Visar Korenica: Pasi në vendin tonë ka përfitime marramendëse të tregjeve komerciale, a ka BQK-ja rekomandime për Qeverinë, që të reduktohen fitimet e drejtpërdrejta për marrjen e kredive në ekonomitë familjare dhe rritjen ekstreme të tarifave të komisioneve?

Ahmet Ismajli, u përgjigj se dividenta është e liruar nga tatimi i politikbërjes fiskale.

Eman Rrahmani: A ka BQK statistika për përfitimin e saktë të bankave nga transaksionet, a ka mbikëqyrje BQK mbi bankat, lidhur me normat e interesit të kredive për vitet 2021-2024?

Ahmet Ismajli, u përgjigj se lidhur me këtë, nuk ka të dhëna aktuale, por bankat janë të obliguara të vendosin tarifatat e tyre konform ligjit në fuqi. Lidhur me mbikëqyrjen e bankave, BQK i auditon bankat me ekip të ekzaminimit tarifal.

Jeta Statovci, tha se duke pasur parasysh se klientët janë të lidhur me institucionet nëpërmjet kredive dhe sot, sistemi bankar nuk është zgjidhje, si vepron klienti në këtë sektor, rritja e mikrofinancave dhe si është ndërveprimi mes BQK-së dhe bankave?

Ahmet Ismajli, tha se kjo është sfidë edhe pse ju ofrojmë mundësi klientëve, institucionet e pagesave të rregulluara me Ligjin për shërbime të pagesave dhe është konform Direktivës së BE-së, ku trajtohet edhe çështja e institucioneve jobankare, që merren me pagesa e në të cilën ka ndihmuar Banka Botërore.

Gjithashtu, është paraparë që një institucion mikrofinanciar që jep shërbime, vlen të theksohet se ka pasur diskutime rreth rritjes së kredive për bujqësi.

Enver Haliti: A ka rregullore apo ndonjë ndryshim të rregulloreve, kundër shpëlarjes së parasë, përditësimit të të dhënave?

Ahmet Ismajli, u përgjigj se Ligji i ri për bankat rregullon çështjen në fjalë, është sistemi E-Kosova.

Kryetari kërkoi nga përfaqësuesit e BQK-së, që me shkrim, të raportojnë lidhur me vendimin rreth benefiteve të BQK-së, për të hyrat nga interesat, rregulloren për zhvillime operationale me para të gatshme, sa nëpunës janë serbfolës dhe sa nëpunës gjithsej i ka BQK, a ka implikime në zbatim të ligjit dhe a ka ndonjë planifikim për rritje të stafit.

Ahmet Ismajli, tha se BQK ka Departamentin për Menaxhimin e Parasë kesh. Sa i përket stafit serbfolës, të gjitha dokumentet publike përkthehen në dy gjuhët zyrtare, ndërsa për rritje të stafit,

si komponent kryesor, është dinamika e punës dhe stafi gëzon autonomi të punës, vetëm deri në zbatim të ligjit.

Kryetari: Si mund të ndërveprojnë BQK, ASK, ATK dhe Dogana, sa i përket interdisiplinaritetit të çështjeve, sepse jo gjithçka është strikte? Si shembull, ATK dhe ASK i publikojnë të dhënat me vonesë për vite (të dhënat për tregun e punës).

Ahmet Ismajli, tha se ka disa marrëveshje, ndër të cilat është marrëveshja me ASK-në për shkëmbim të të dhënave për para të gatshme.

Kryetari propozoi që raporti të shtyhet për votim në mbledhjen e radhës, pasi të shqyrtohen edhe të dhënat e kërkuara shtesë.

14. Të ndryshme

Kryetari pyeti anëtarët e Komisionit, se a ka diçka në pikën të ndryshme, meqë nuk pati, e përfundoi mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

Përgatitur nga: Stafi mbështetës i Komisionit.

Armend Muja,

Kryetar i Komisionit